

AKT THEMELIMI



I SHOQERISE TREGETARE "INTER - GAZ" SH.A

Anteret per Themelimin e Shoqerise Tregetare "Inter – Gaz" Sh.A te mbledhur me daten 20.3.2002 spas Ligjit Per Shoqerite Tregetare Nr.7638 date 19.11.1992, sipas ligjit Mbi regjistrimin e Shoqerive Tregetare Nr. 7667 dt.28.01.1993 dhe sipas ligjit nr.8450 dt.24.02.1999 Mbi perpunimin, transportin dhe tregetin e gazoilit, gazit dhe nenprodukteve te te tij, vendosen themelime shoqerise "Inter - Gaz" SH.A.

Aksioneret themelues te shoqerise jane :

1. Piro BARE i biri i Leksit dtl. 01.06.1958 lindur e banues ne Fier, me nenshtetesi shqiptare me pasaporte NF 000020.
2. Artan Dulaku i biri i Nikos i dtl.30.05.1965 lindur e banues ne Tirane me pasaport nr.0128812.

Te siper permendurit, madhor eme zotesi te plote juridike, rane dakorte per sa vijon :

Neni 1

Aksioneret qe nenshkruajne kete akt rane dakort per themelimin e nje shoqerie duke u bazuar ne Aktin e Themelimit dhe ne Statut dhe duke respektuar ate cfare kerkon legjislacioni shqiptar.

Neni 2

Emertimi i shoqerise do te jete : "Inter – Gaz" Sh.A.

Neni 3

Objekti i Shoqerise do te jete :
Tregetimi me shumice i Gazit, Naftes dhe nenprodukteve te tyre.

Neni 4

Vendi i zhvillimit te aktivitetit te shoqerise eshte territori i Shqiperise, selia e shoqerise do te jete ne Tirane, ne Rrugen Perlat Rexhepi Nr.184/4.

Me vendim të Keshillit Mbikqyres mund të hapen filiale, zyra dhe shërbime në të gjithë territorin e Shqipërisë si dhe jashtë saj.

Neni 5

Kohezgjatja e aktivitetit të Shoqërisë është vendosur për 30 vjet duke filluar nga data e regjistrimit në gjykatë. Shoqëria mund të shpërbehet edhe para skadencës së 30 vjetëve, ose mund të zgjaset afatin me vendim të asamblesë së përgjithëshme të jashtëzakonëshme të aksionerëve, sipas legjislacionit shqiptar.

Neni 6

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 2.000.000. leke.(dy milionë).Kapitali është ndarë në dy mijë aksione me vlerë nominale 1000 leke secila (njemijë).

Neni 7

Themeluesit që nënshkruajnë këtë akt kontribuojnë në kapitalin e shoqërisë me nga 50 % të aksioneve secili.

Neni 8

Ky akt është formuluar në 5 kopje, pasi është firmosur me vullnetin e lirë e të plotë të palëve para noterit. Një kopje depozitohet pranë Zyres së Noterisë Tiranë, një kopje në Gjykatën e Rrethit Tiranë, një kopje pranë organeve të Tatimeve dhe Taksave dhe dy kopje depozitohen pranë shoqërisë.


Themeluesit

Dino BARE

1. Piro BARE



2. Artan DULAKU



STATUTI

I SHOQERISE TREGETARE "INTER – GAZ" SH.A.

Kapitulli 1

Themelimi, emertimi, selia, aktiviteti i shoqerise, kohezgjatja dhe kapitali.

Neni 1

Aksioneret themelues te shoqerise jane :

1. Piro BARE i biri i Leksit i dtl.01.06.1958 lindur e banues ne Fier, me nenshtetesi shqiptare me nr.pasaporte NF.000020
2. Artan DULAKU i biri i Nikos i dtl. 30.05.1965 lindur e banues ne Tirane, me nenshtetesi shqiptare, me nr.pasaporte 0128812.

Neni 2

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj me emertimin "INTER – GAZ" SH.A., duke u bazuar

Ne statutin dhe aktet e tjera te saj, duke respektuar ligjet e shtetit shqiptar dhe ne vecanti ligjin Nr.7638 dt.19.11.1992 Mbi regjistrimin per Shoqerite Tregetare

Neni 3

Shoqeria aktivitetin e saj do ta zhvilloje ne teritorin e Shqiperise, selia e shoqerise do te jete ne Tirane ne Rrugen "Perlat Rexhepi" Nr.184/4. Shoqeria mund te hape perfaqesi apo filialet e saj edhe ne rrethe te tjera te vendit si dhe jashte tij

Neni 4

Objekti i Shoqerise do te jete :

Tregtimi me shumice i gazit, naftes dhe nenprodukteve te tyre.



Neni 5

Shoqëria "INTER – GAZ" SH.A. do të ushtroje aktivitetin e saj për një periudhë kohe prej 30 vjetësh, duke filluar nga data e regjistrimit në Gjykatë. Shoqëria mund të shpërbehet edhe para skadencës së 30 vjetëve, ose mund të zgjas afatin me vendim të asambles së jashtëzakonshme të aksionerëve sipas legjislacionit shqiptar.

Neni 6

Kapitali i Shoqërisë.

Shoqëria "INTER – GAZ" Sh.A. ka një kapital themeltar prej 2.000.000 leke të depozituar pranë Bankës Kursimeve. Ky kapital perfaqësohet në shoqëri nga 2000 aksione (dymije) me vlerë nominale 1000 (njemije) leke secili të cilat zotërohen nga të dy aksionerët me vlerë 50 % secili.

Neni 7

Transferimi i aksioneve :

Çdo aksioner pjesëmarrës në shoqëri ka të drejtë të transferojë lirisht aksionet e tij nominative tek pjesëtarët e familjes si dhe në rrugë trashëgimie, ndërsa kur ky transferim bëhet tek të tretët duhet marrë pëlqimi i aksionerëve të tjerë të shoqërisë që gezojnë të drejtën e parableries. Çdo transferim duhet të pasqyrohet në regjistrat që mban shoqëria duke respektuar kërkesat e parashikuara në ligj.

Kapitulli 2

Asambleja

Neni 8

Asambleja e thirrur dhe e përbërë rregullisht, perfaqëson interesin e aksionerëve. Vendimet e saj të marra në përputhje me ligjin dhe statutin e shoqërisë janë të detyrueshme për të gjithë aksionerët edhe në qoftëse nuk kanë marrë pjesë apo nuk janë dakort.



Neni 9

Modalitetet e thirrjes se Asamblese

Asambleja thirret nga Keshilli Mbikqyres ose nga Drejtoria. Ne mungese ajo mund te thirret gjithashtu :

- Nga ekspertet kontabel te autorizuar.
- Nga nje mandat mbajtes i caktuar me vendim gjyqesor, me kerkesen e çdo personi te interesuar per nje rast urgjent.
- Me kerkesen e nje ose disa aksionereve qe zoterojne te pakten 1/10 e kapitalit themeltar.
- Nga likujduesit.

Neni 10

Vendi dhe Menyra e njoftimit te Asamblerse

Thirrja e Asambles si rregull behet ne seli te Shoqerise. Ne rast te kundert secili nga aksioneret duhet te njoftohet per vendin ku do te zhvillohet mbledhja e Asamblese. Njoftimi behet me shkrim duke u caktuar gjithashtu dita, ora dhe rendi i dites i mbledhjes. Njoftimi behet 15 (pesmedhjet) dite perpara mbledhjes se Asamblese .

Neni 11


Perfaqesimi i nje Aksioneri

Nje aksioner mund te perfaqesohet nga nje tjetër aksioner apo nga bashkeshorti.

Neni 12

Drejtimi dhe procedura e mbledhjes se Asamblese.

Mbledhja e Asamblese e shoqerise "INTER - GAZ" drejtohet nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres (apo Zv. i tij kur mungon Kryetarii Keshillit mbikqyres). Ne çdo mbledhje e Asamblese mbahet proces verbal ku pasqyrohet



pjesmarrja dhe zhvillimi i mbledhjes. Proces verbali nenshkruset nga drejtuesi i mbledhjes se asambles si dhe sekretari qe mban proces verbalin.

Neni 13

Asambleja e zakoneshme.

Ne mbledhjen e Asambles se zakoneshme mund te marre pjese cdo aksioner, pavaresisht nga numri i aksioneve qe zoteron. Pervec aksionereve ne mbledhje duhet te marri pjese anetaret e Keshillit Mbikqyres, Perfaqesuesit e Drejtorise, Ekspertet Kontabel si dhe persona te tjere si p.sh. noteri (ne rast se cmohet e nevojshme).

Vendimet e Asamblese se zakoneshme ne mbledhjen e pare jane te vlefshme kur marrin pjese aksioneret qe zotrojne mbi 50 % te aksioneve dhe kur merren me shumice votash (mbi 50 %).

Ne raste se mbledhja e pare nuk realizohet per mungese kuorumi, ne mbledhjen e dyte nje kerkes e tille nuk kerkohet, por vendimet merren me shumicen e votave te aksionereve te pranishem.


Asambleja e zakoneshme thirret ne mbledhje te pakten nje here ne vit, brenda 6 muajve qe pasojne mbylljen e vitit financiar.

Asambleja shqyrton dhe vendos per ceshtjet qe kane te bejne me mbylljen e vitit financiar dhe projektit e ri te vitit financiar. Asambleja e zakoneshme ka kopetenca vendimarrjeje konform statutit dhe ligjit, me perjashtimn te atyre kopetencave qe i perkasin asambles se jashtzakoneshme.

Neni 14

Asambleja e Jashtzakoneshme

Ne mbledhjene asambles se jashtzakoneshme mund te marre pjese cdo aksioner, pavarsisht nga vlere e aksioneve qe ka ne shoqeri. Gjithashtu duhet te marrin pjese dhe antaret e Keshillit Mbikqyres, perfaqesuesit e Drejtoris dhe kur eshte rasti edhe noteri. Njoftimet behen me shkrim. Vendimet e Asambles se jashtzakoneshme te mbledhur me thirrjen e pare, jane te vlefshme kur merren nga aksioneret qe perfaqesojne te pakten $\frac{3}{4}$ e aksioneve te shoqerise (me 75 % te votave). Ne raste se mbledhja e pare, ndonese e thirur ne menyre te rregullt, nuk realizohet per mungese kuorumi (te pakten te aksionereve qe zoterojne jo me pak se 75 % te kuotave te shoqerise), njoftimi behet per nje date tjeter, por jo me larg se dy muaj.



Vendimet e Asambles se jashtzakonshme te thirur ne mbledhjen e dyte jane te vlefshme kur asistojne aksioneret qe zotrojne jo me pake se 50 % te aksioneve ne shoqeri dhe vendimet merren me 75 % te votave.

Ne se edhe mbledhja e dyte e Asambles se jashtzakonshme nuk realizohet per mungese kuorumi, atehere thirrja e asambles caktohet per nje date tjeter duke u zbatuar te njejtat rregulla e kriteret si ne rastin e thirrjes se dyte. Keshtu veprohet deri ne thirrjen e Asambles se jashtzakonshme; kur nuk realizohet pjesmarrja (kuorumi) e caktuar per vendim marrje.

Asambleja e jashtzakonshme mblidhet dhe vendos per rastet qe vijojne :

1. Mbylljen e parakoshme te shoqerise.
2. Shndrimin e shoqerise ne nje shoqeri tjeter.
3. Ndryshimin e statutit.
4. Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te shoqerise.
5. Bashkimin ose shkrirjen e shoqerise me nje shoqeri tjeter.

Si dhe per te gjitha rastete tjera te parashikuara shprehimisht ne ligjin Nr,7638 dt. 19.11.1992 Per Shoqerite Tregetare.

Kapitulli 3


Keshilli mbikqyres

Neni 15

Kompetencat

Keshilli Mbikqyres ushtron kontroll te vazhdueshem ndaj Drejtoris per administrimin e shoqerise nga ana e saj. Perfundimi i operacioneve te renditura ne statut mund te behet me autorizimin paraprak te Keshillit mbikqyres.

Keshilli mbikqyres ka te drejte te kryeje ne çdo kohe verifikimet dhe kontrollet qe ai i çmon te arsyeshme si dhe te kerkoj te njihet me dekuementat qe ai gjykon te nevojshme per plotesimine detyres se tij. Drejtoria i paraqet raport Keshillit mbikqyres te pakten nje here te tre muaj brenda tre muajeve nga mbyllja e vitit financiar, drejtoria i paraqet Keshillit mbikqyres llogarite vjetore dhe ne raste se eshte e nevojshme edhe llogarite e konsoliduara.



Neni 16

Perberja

Keshilli mbikqyres i Shoqerise "INTER - GAZ" Sh.A. perbehet nga tre deri ne gjashte antare, nga te cilet te emruar nga Mbledhja e pare e Asambles jane :

1. Fatmir HOXHA i biri i Elezit, dtl.07.05.1954, lindur ne Shkoder banues ne Tirane me nr.pasaporte 054898.
2. Elida FURXHI e bija e Zoit dtl. L963 lindur ne Lushnje banues ne Tirane me nr.pasaporte 19234.
3. Agim MIMANI i biri i Xhezmiut dtl.1951 lindur ne Ballsh banues ne Tirane me nr.pasaporte 564386.

Kryetari i keshillit Fatmir HOXHA
Zv. Kryetare Elida FURXHI
Antar Agim MIMANI

Antaret e Keshillit mbikqyres te siperpermendur do te ushtrojne aktivitetin e tyre per nje afat kohe prej 3 (tre) vjetesh me te drejte rizgjedhjeje. Me vendim te Asambles se zakonshme numri i antarteve te keshillit mbikqyres mund te rritet por nuk mund te kalohet numri i te 21 (njetzet e nje) antareve. Ne çdo rast numri i antareve te Keshillit mbikqyres nuk mund te jete me i vogel se tre dhe duhet te jete i plotpjestueshem me tre. Shkarkimi i antareve te Keshillit mbikqyres behet me vendim te Asambles se zakonshme.

Neni 17

Kryetari dhe Zv Kryetari i Keshillit mbikqyres ; marrja e vendimeve.

Keshilli mbikqyres zgjedh nga gjiri i tij Kryetarin dhe Zv.kryetarin e tij te cilet drejtojne mbledhjen e keshillit mbikqyres (zv.kryetari drejton ne munges te kryetarit). Keshilli mbikqyres mund tre marre vendime te vlefshme kur pjesmarrja eshte 50 %. Ne rast se votimi rezulton i barabarte, vota e drejtuesit te mbledhjes eshte percaktuese.

Kapitulli 4

Drejtoria



Neni 18

Shoqeria "INTER - GAZ" Sh.A. drejtohet nga Drejtori dhe Zv.drejtori i saj qe emrohe nga Keshilli mbikqyres dhe atsa jane :

Drejtor Frederik BARE i biri i Leksit dtl. 1960 lindur ne Fier banues ne Tirane.

Zv.Drejtor Asqeri ASLLANI i biri i Jaupit dtl. 03.06.1951 lindur ne Fier banues ne Tirane.

Kohezgjatja e mandatit te tyre eshte tre vjet me te drejte rizgjedhje.

Shkarkimi i antareve te drejtorise nga Keshilli Mbikqyres duhet te jete per shkaqe te perligjura.

Kunder vendimit te shkarkimit te mara nga Keshilli Mbikqyres mund te behet ankim ne gjykate.

Shkarkimi mbetet ne fuqi deri sa vendimi gjyqesor qe evidenton pavlefshmerine e shkarkimit te marre fuqi ligjore.

Neni 19

Kompetencat e Drejtoris dhe marrja e vendimeve

Drejtoria ka kompetenca te plota per te vepruar ne çdo rrethane ne emer te shoqerise. Ajo u ushtron keto kompetenca brenda objektrit te shoqerise, por kufizohet nga ato kompetenca qe ligji ua jep shprehimisht Keshillit Mbikqyres dhe Asambles se Aksionereve. Shoqeria ne mardhenie me te tretet merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e Drejtoris nese keto veprime nuk jane tej objektit dhe veprimtarise se shoqerise. Vendimet i marrin ne unanimitet.

Neni 20

Pergjegjesia

Antaret e Drejtoris jane pergjegjes individualisaht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqerise e ndaj te treteve, per shkelje te dispozitave ligjore statutit dhe vendimeve te shoqerise si dhe per gabimet e bera ne administrimin e shoqerise.

Kapitulli 5



Ekspertet Kontabel te Autorizuar

Neni 21

Ekspert Kontabel i autorizuar i Shoqeris "INTER - GAZ" Sh.A. eshte Z.Peri BUZALI i biri i Xhevitit dtl.1948 lindur e banues ne Tirane me nr.pasaporte UG 037925 dhe nr. Licence 33.

Neni 22

Shoqeria mund te kete nje ose disa ekspert kontabel te autorizuar, te cilet kane kompetence per te ushtruar kontrollin ekonomik – financiar te shoqerise.

Emrimi i tyre behet nga Asambleja e jashtzakonshme duke respektuar kerkesat e percaktuar ne ligjin 7638 dt. 19.11.1992 Per Shoqerite Tregetare.

Ekspertet kontabel te autorizuar emrohen per nje vit financiar.

Funksionet e tyre perfundojne pas mbledhjes se Asambles se zakonshme e cila merr vendim mbi llogarit vjetore. Me vendim te Asamblese, ekspertet mund te rizgjidhen ne funksionin e tyre per nje vit te ri financiar.

Emrimi i eksperteve mund te kundershohet ne rruge gjyqesore nga nje ose disa aksioner qe zotrojne te pakten 1/10 e aksioneve te shoqerise, brenda nje afati 30 ditor nga data e emrimit.


Neni 23

Detyrat e Eksperteve

Ekspertet kontabel te autorizuar jane pergjegjes ne garantimin e vertetesise dhe sakesise te llogarive vjetore e te gjendjes ekonomik-financiare te shoqerise per te cilen ushtron kontroll. Ekspertet kontabel gezojne te drejten e kontrollit te vazhdueshem te shoqerise dhe nuk mund te pengohen ne kryerjen e detyres se tyre.

Ekspertet kontabel te autorizuar duhet tu bejne te njohur drejtorise dhe keshillit mbikqyres :

1. Kontrolllet, verifikimet, sondazhet qe kane kryer.
2. Pjeset e bilancit dhe te dokumentave te tjera te kontabilitetit per te ballafaquar vrejttet e tyre ne sakesimin e te dhenave



3. Parregullsitet dhe pasaktesitet që kanë zbuluar.
4. Perfundimet që rrjedhin nga vërtjetet dhe korigjimet e mesipërme mbi rezultatet e vitit financiar, të krahasuara me vitin e kaluar financiar.

Eksperet kontabel të autorizuar marrin pjesë në mbledhjen e Drejtorisë për analizën e vitit financiar si dhe në mbledhjet e Këshillit mbikqyres dhe të Asamblesë së aksionereve, kur çmohet e domozdoshme pjesëmarrja e tyre.

Neni 24

Përgjegjësia

Eksperet kontabel të autorizuar janë përgjegjës si ndaj shoqërisë dhe ndaj të tregëve për pasojat e demshme që rrjedhin për fain e tyre në ushtrimin e funksionit si ekspert të autorizuar.

Ata nuk janë ligjrisht përgjegjës për shkeljet e ligjit të kryera nga antaret e drejtorisë, me përjashtim të rasteve kur kanë dëni për to, por nuk i kanë paraqitur.

Neni 25

Shkarkimi nga detyra

Në rast gabimi ose pengimi ekspertet kontabel të autorizuar mund të shkarkohen nga detyra me vendim gjyqësor.

Kapitulli 6

Dispozita të Fundit

Neni 26

Ruajtja e fshehtësisë

Punonjësit e shoqërisë, antaret e këshillit mbikqyres, të drejtorisë, ekspertet si dhe aksioneret, janë të detyruar të respektojnë ruajtjen e fshehtësisë të të dhënave e informacioneve që përbejnë sekret për shoqërinë duke respektuar ligjin.



Neni 27



Neni 27

Likuidimi


Nese shoqeria prishet(mbyllet),emertimi i shoqerise pasohet me shenimin « shoqeri ne likuidim e siper », ekzistenca e shoqerise si person juridik mbetet per nevojat e likuidimit deri ne perfundim te ketij procesi.

Neni 28

Referimi

Per çka nuk eshte shprehur ne kete statut zbatohen dispozitat perkatese te parashikuara ne ligjin 7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite Tregetare" si dhe ne ligjin 8450 dt.24.02.1999 "Per perpunimin transportin dhe tregtimin e Gazoilit, gazit dhe nenprodukteve te tij.

Persa parashikohet ne kete statut eshte ne perputhje me vullnetin e lire e te plote te aksionereve te shoqerise qe e nenshruan perpara noterit.

Piro BARE
Piro BARE


2.Artan DULAKU

Artan Dulaku
